



INTERNATIONAL ASSOCIATION OF LANGUAGE COMMISSIONERS

Konferenca e Pestë Vjetore e Asociacionit
Ndërkombëtar të Komisionerëve për Gjuhët
“SHUMËGJUHËSIA: VLERË DHE/APO
OBLIGIM”

Prishtinë, Kosovë
04 maj 2018

Ky raport është përgatitur nga: Bleta Polloshka

Përmbajtja

Historiku.....	2
Fjalimet hyrëse	2
Sesioni i parë: Avancimi i ofrimit të shërbimeve në gjuhët zyrtare, oferta aktive.....	3
Fjalime nderi	5
Sesioni i dytë: Nxitja e mësimit të gjuhëve zyrtare përmes arsimit, sfidat dhe mundësitë	5
Sesioni i tretë: Ballafaqimi me të kaluarën, statusi i gjuhëve në shoqëritë e dala nga konflikti dhe ndikimi i tij në procesin e pajtimit	9
Platforma online për mësimin e gjuhës	12
Sesioni përmbledhës	12
Fjalimet përmbyllëse	14

Historiku

Konferenca e pestë vjetore e Asociacionit Ndërkombëtar të Komisionerëve për Gjuhët u mbajt më 4 maj 2018. Zyra e Komisionerit për Gjuhët e Republikës së Kosovës kësaj radhe ishte nikoqire e këtij evenimenti. Misioni i këtij asociacioni është mbështetja dhe avancimi i të drejtave gjuhësore, barazisë dhe diversitetit duke mbështetur komisionerët për gjuhët në botë për të punuar sipas standardeve më të larta profesionale. Anëtarët e asociacionit shkëmbejnë përvojën, hulumtimin dhe informacionin; lehtësojnë trajnimet dhe bashkëpunojnë me organizata të ngjashme. Tema e konferencës së këtij viti ishte “Shumëgjuhësia: vlerë dhe/apo obligim”. Shumë anëtarë të Asociacionit Ndërkombëtar të Komisionerëve për Gjuhët ishin të pranishëm dhe disa nga ata mbajtën prezantimet e tyre në disa nga sesionet. Në konferencë ishin të pranishëm edhe shumë anëtarë të shoqërisë civile, profesorë dhe nëpunës civil.

Fjalimet hyrëse

Ceremonia u hap nga Komisioneri për Gjuhët i Kosovës, z. Slaviša Mladenović, i cili u shprehu mirëseardhje të ngrohtë të gjithë pjesëmarrësve në konferencë. Në fjalimin e tij, z. Mladenović, theksoi ndër të tjera që mbrojtja dhe promovimi i të drejtave gjuhësore është obligim për mbrojtjen e të drejtave themelore njerëzore dhe është thelbësor për qeverisje të mirë. Këto të drejta janë shumë të rëndësishme për një shoqëri demokratike, ato janë elemente themelore për ruajtjen e identitetit kulturor dhe për parandalimin e marginalizimit dhe diskriminimit. Janë shumë të rëndësishme në parandalimin e tensioneve dhe konflikteve ndërmjet komuniteteve shumicë dhe pakicë. Kosova ka një kornizë ligjore gjuhësore shumë të avancuar me Ligjin nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve zyrtare, në Kushtetutë dhe Rregulloren nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët. Gjuha shqipe dhe gjuha serbe kanë status të barabartë si gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës. Edhe pse Kosova ka legjislacion modern për të drejtat gjuhësore, akoma ekzistojnë vështirësi në zbatimin e tyre në jetën tonë të përditshme në Kosovë. Konferenca e këtij viti do të ofrojë mundësinë për shkëmbimin e ideve dhe praktikave të mira për tejkalimin e sfidave në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore.

Z. Slaviša Mladenović prezantoi folësin e radhës, ekselencën e tij Kryeministrin e Kosovës z. Ramush Haradinaj. Ai informoi publikun që Kosova ka dy gjuhë zyrtare – gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe. Edhe pse gjuha serbe ka vështirësitë e saj në zbatim, i gjithë legjislacioni qeveritar përgatitet në të dyja gjuhët. Ai i inkurajoi të gjithë që të mësojnë gjuhën e njëri tjetrit. Z. Haradinaj pati një kërkesë publike lidhur me atë se në të ardhmen tonë evropiane ne duhet të njohim gjuhën e njëri tjetrit dhe të respektojmë gjuhën e tjetrit. Ai tha që “ne respektojmë të tjerët nëse njohim gjuhën e tyre dhe i përshëndesim ata në atë gjuhë.”

Folësja e radhës, Meri Huws, Komisionere për Gjuhën Uellsiane dhe Kryetare në Largim e Asociacionit Ndërkombëtar të Komisionerëve për Gjuhët, tha fjalë të mëdha për asociacionin të cilin e ka udhëhequr për dy vite dhe vlerësoi punën e të gjithë përfaqësuesve të secilit juridiksion dhe komisionerëve për gjuhët të çdo anëtar të komisionit. “Ky Komision nuk është më “fëmijë”, është rritur dhe çdo anëtar i tij e njeht rolin e tij mbi të drejtat gjuhësore në vendin që ata përfaqësojnë. Si asociacion, ne shkëmbejmë përvoja, jemi individë që përkrahim njëri tjetrin, shkëmbejmë analiza dhe Kosova është pjesë thelbësore

e saj”, tha ndër të tjerash Meri Huws. Konferencat vjetore të asociacionit kanë dëshmuar të jenë shumë të rëndësishme në fuqizimin e të kuptuarit tonë ndërkombëtar dhe në mësimin nga përvojat dhe praktikat më të mira nga juridiksionet tjera.

Sesioni i parë: Avancimi i ofrimit të shërbimeve në gjuhët zyrtare, oferta aktive

Sesioni u kryesua nga Ivan Nikolić, Drejtor i OJQ-së “CSD” në Kosovë. Ai theksoi që në Kosovë kemi problem në zbatimin e gjuhëve zyrtare. Për këtë arsye, organizata e tij ka hartuar plane dhe strategji në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për Gjuhët. Mesazhi i tij për të gjithë të rinjtë e të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë është të mësojnë gjuhën e njëri tjetrit në mënyrë që të respektojnë njëri tjetrin.

Folësi i parë i sesionit, z. Raymond Théberge, Komisioner për Gjuhët Zyrtare i Kanadasë në Ottawa, mbajti një prezantim me temën “Avancimi i ofrimit të shërbimeve në gjuhët zyrtare- oferta aktive”. *Oferta Aktive*¹ është mjet i cili, siç tha z. Théberge, është punë e ekipit të tij në Kanada për punonjësit në qeveri.

Para se të vazhdojë me shpjegimin se çka është oferta aktive, ai prezantoi kontekstin në bazë të të cilit është zhvilluar ky mjet. Sipas regjistrimit të vitit 2011, 98% e kanadezëve mund të realizojnë një bisedë në cilëndo gjuhë zyrtare. Më shumë se 94% e kanadezëve flasin një nga dy gjuhët zyrtare rregullisht në shtëpi, 57% flasin gjuhën angleze si gjuhën e tyre të parë dhe 21.7 % flasin gjuhën frënge si gjuhën e tyre të parë. Ky dualitet gjuhësor reflektohet në Kanada në ofrimin e shërbimeve nga institucionet federale të cilat kërkohen me ligj që të ofrojnë shërbimet në të dyja gjuhët. Në vitin 2016 ata realizuan një anketë e cila theksoi që punonjësit federal nuk janë të vetëdijshëm që oferta aktive është obligim i tyre dhe ata supozojnë rreth preferencës gjuhësore të klientit dhe që klienti është në dijeni për shërbimet e ofruara në të dyja gjuhët zyrtare.

Oferta aktive është një ofertë që punonjësit federal duhet t’ua bëjnë klientëve të tyre me qëllim të informimit të tyre që shërbimet janë në dispozicion në të dyja gjuhët dhe t’i bëjnë ata të ndjehen rehat. Edhe pse ka shenja vizuale që paraqesin disponueshmërinë e shërbimeve në të dyja gjuhët, oferta aktive verbale i bënë njerëzit të ndjehen rehat duke kërkuar shërbime në gjuhën e tyre. Oferta aktive duhet të ofrohet nga punonjësit federal në të gjitha nivelet për të siguruar ekselencën në shërbim. Menaxherët, gjithashtu, duhet të luajnë rol pasi që ata duhet të sigurohen që ka punonjës për ofrimin e shërbimeve në të dyja gjuhët dhe duhet të përfshijnë në të vlerësimin e performancës së punonjësve të tyre. Zyrtarët ekzekutivë duhet t’i demonstrojnë leadershipit për t’i treguar që oferta aktive është prioritet. Kultura e ofertës aktive fillon me leadershipin dhe ajo duhet të jetë pjesë e çdo organizate. Sigurohuni që klientët mund të vijnë në zyrat e tyre dhe sigurohuni që shërbimet do të ofrohen në gjuhën tyre të parë. Është e rëndësishme që një person që ka kompetenca të bëjë gjithashtu një ofertë aktive pasi që personat janë të pasigurt kur kanë të bëjnë me këto autoritete dhe harrojnë të kërkojnë shërbimin në gjuhën e tyre.

¹ Oferta aktive. Në dispozicion në: <http://www.ocol-clo.gc.ca/sites/default/files/active-offer-tool.pdf> [Qasur më 20 maj 2018]

Folësi i radhës, z. François Boileau, Komisioner për Gjuhët në Ontario, Kanada, mbështeti folësin paraprak në Ofertën Aktive dhe mbajti një prezantim me temën “Përfshirja e Ofertës Aktive në çfarëdo Akti të gjuhëve zyrtare”.

Ai tha se nuk është njëjtë të flitet lidhur me të drejtat gjuhësore këtu me ato në Kanada. Z. Boileau vjen nga Ontario, e cila është provinca më e madhe në Kanada, ku gjuha angleze është gjuha kryesore pasi që vetëm 5% e popullsisë flasin gjuhën frënge. Kjo përqindje e vogël e popullsisë që flet gjuhën frënge i bënë ata minoritet në atë zonë dhe ofrimi i shërbimeve në gjuhën frënge nuk është gjithmonë i barabartë me ofrimin e shërbimeve në gjuhën angleze, edhe pse ekziston Akti për Shërbimet në Gjuhën Frënge për të siguruar që respektohen të drejtat për komunikim dhe shërbime të ofruara në gjuhën frënge nga qeveria provinciale. Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit për Shërbime në Gjuhën Frënge i Ontarios lëshoi dokumentin “*Special Report on Active offer of Services in French: The Cornerstone for Achieving the objectives of Ontario’s French Language Services Act*” (Raporti special për ofertën aktive në gjuhën frënge: Gurthemeli për arritjen e objektivave të aktit të shërbimeve gjuhësore frënge në Ontario)². Ky raport përfshinë mangësitë në ofertën e shërbimit dhe reflekton efektet në cilësinë e shërbimit.

Z. Boileau përmendi gjashtë elemente kryesore për përmirësimin e mangësive:

- Të sigurohet që publiku është i informuar lidhur me disponueshmërinë e shërbimeve;
- Të bëhet oferta për shërbime në dy gjuhë, duke filluar që në kontaktin e parë;
- Të sigurohet klienti që mund të zgjedhë shërbimet në cilëndo gjuhë;
- Të sigurohet që shërbimi ofrohet në mënyrë të përshtatshme kulturore;
- Të sigurohet që klienti ndjehet rahat me mënyrën e ofrimit të shërbimeve;
- Të sigurohet që shërbimi i ofruar ka cilësi të barabartë me atë të gjuhës së shumicës.

Ekzistojnë shumë shembuj në jetën reale të mungesës së shërbimeve në gjuhën frënge në disa nga shërbimet më të rëndësishme, si kujdesi shëndetësor dhe drejtësia, të cilat kanë vendosur folësit e gjuhës frënge në një pozitë të disfavorshme.

Folësja e fundit në këtë sesion ishte z. Rozafa Ukimeraj – Çuni, Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë. Ajo bëri një prezantim lidhur me punën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për fuqizimin e përdorimit të të gjitha gjuhëve zyrtare të Kosovës. Në disa nga komunat e Kosovës ekzistojnë më shumë se dy gjuhë zyrtare, p.sh. gjuha e komunitetit turk apo rom.

Komunat hartojnë rregullore lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe sot 34 nga 38 komuna kanë rregulloret e tyre. Është e rëndësishme të përmendet që gjatë takimeve komunale ka përkthim simultant për pjesëmarrësit jo-shqiptarë në takim. Megjithatë, në shumicën e rasteve komunat nuk e respektojnë shumë-gjuhësinë kur hartojnë rregullore dhe i përkthejnë dokumentet. Kjo nganjëherë ndërlikohet me koston e lartë për përkthimin e dokumenteve zyrtare. Kjo do të vazhdojë të jetë një sfidë

²Special Report on Active offer of Services in French: The Cornerstone for Achieving the objectives of Ontario’s French Language Services Act, 2016. Në dispozicion në: http://csfontario.ca/ep-content/uploads/2016/11/OFLSC-257785-Special-Report_October-2016_ENG.pdf [Qasur më 20 maj 2018]

për aq sa komunat nuk kanë buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Komunat kanë përditësuar ueb-faqet e tyre dhe ato tani janë në dy gjuhët zyrtare të Kosovës dhe gjuhën angleze. Të gjitha raportet e ndryshme të komunave përkatëse mund të gjenden në tri gjuhët.

Fjalime nderi

Jan Braathu – Ambasador në Misionin e OSBE-së në Kosovë. Z. Braathu deklaroi se sa i kënaqur është që kësaj radhe konferenca po realizohet në Prishtinë, pasi që misioni i OSBE-së ka mbështetur vazhdimisht të drejtat e komunitetit në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe të drejtat gjuhësore. Ai theksoi që e tërë fryma e një komuniteti është e mishëruar në një gjuhë. Ne duhet të kuptojmë gjuhën e fqinjëve tanë për të kuptuar kulturën e tyre.

Në të kaluarën populli i Kosovës ka folur gjuhën shqipe, serbe dhe turke dhe sot të rinjtë e Kosovës nuk janë duke e bërë një gjë të tillë, ndoshta për shkak të mungesës së mundësisë për të mësuar këto gjuhë. Kosova aplikon shumë-gjuhësinë dhe ia vlen të ruhet kjo edhe në të ardhmen. Rinia e saj dëshiron të mësojë gjuhë të tjera dhe pse mos të mësohet gjuha e komuniteteve që jetojnë në vendin e tyre. Ai rekomandoi leximin e *Rekomandimeve të Oslos* së vitit 1998, që ka të bëjë me të drejtat gjuhësore të minoriteteve kombëtare dhe OSBE-ja i ka promovuar ato në mënyrë aktive në Kosovë që nga fillimi i misionit.

Z. Kuno Schlaefli, Sekretar i Parë – Këshilltar i Burimeve Njerëzore nga Ambasada e Zvicrës mbajti një fjalim në emër të Ambasadës së Zvicrës në Kosovë. Ai theksoi që gjuha është politikisht e ndjeshme në Kosovë dhe se gjuha është fuqi – mund të përdoret për ndarje apo integrim. Njohja e dy apo më shumë gjuhëve zyrtare të vendit ku jetoni është një përparësi. Në Zvicër, njohësit e gjuhës frënge kanë mundësi të marrin pagë më të lartë prej 40%.

Në Kosovë ekziston një situatë ku asnjë serb nuk mëson gjuhën shqipe dhe asnjë shqiptar nuk mëson gjuhën serbe. Kosova duhet të hartojë një strategji për ofrimin e një zgjidhjeje për këtë situatë, pasi që ekziston një çështje e shumicës serbe/shqiptare. Ai përfundoi fjalimin e tij me një citat: *“Gjuha është armë – mbajeni të mprehtë.”*

Sesioni i dytë: Nxitja e mësimin të gjuhëve zyrtare përmes arsimit, sfidat dhe mundësitë

Ky sesion u kryesua nga z. Adrian Zeqiri, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së “ECMI”- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë. Organizata e tij zhvilloi një projekt për avancimin e Ligjit për gjuhët që do të ofrojë kornizë ligjore dhe të politikave për përdorimin e gjuhëve në Kosovë. Zyra e Komisionerit për Gjuhët përcaktoi të drejtat gjuhësore të secilit komunitet në Kosovë, përdorimin e barabartë zyrtar të gjuhës serbe dhe shqipe, si dhe ka punuar palodhshëm në zbatimin e ligjit.

Pasi që z. Zeqiri nuk mundi të qëndrojë deri në fund të sesionit, ky sesion më pas u kryesua nga znj. Safete Grajqevci, Koordinatorë për Sigurimin e Përputhshmërisë në kuadër të Zyrës së Komisionerit për Gjuhët të Republikës së Kosovës.

Folësi i parë i këtij sesioni, z. Sadik Idrizi, profesor në Universitetin e Prizrenit në Kosovë, mbajti një prezantim të titulluar “Rëndësia e arsimit të lartë në gjuhët e minoriteteve. Rast studimi: Universiteti i Prizrenit”. Z. Idrizi filloi prezantimin e tij duke folur në përgjithësi për të drejtat gjuhësore dhe të komunitetit. Përdorimi i gjuhës tuaj është një nga të drejtat themelore dhe gjuha iu përcakton juve si pjesëtarë të komunitetit dhe kulturës, na lejon të ruajmë dhe të transmetojmë kulturën tonë tek gjeneratat e ardhshme. Nuk ka rëndësi nëse gjuha juaj është njëra nga gjuhët e minoriteteve të atij vendi: prapë është një nga të drejtat tuaja themelore. Të drejtat gjuhësore në Kosovë përcaktohen me dokumentet kryesore të legjislacionit të Republikës së Kosovës. *Neni 5 i Kushtetutës së Kosovës*³ përcakton gjuhën shqipe dhe serbe si dy gjuhët zyrtare në Kosovë, përderisa gjuha turke, boshnjake dhe romë kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal. Kosova ka bazë të mirë ligjore për gjuhët zyrtare, por problem mbetet zbatimi i saj.

Universiteti i Prizrenit, i cili ishte themeluar në vitin 2009 dhe kishte filluar punën nga viti 2010, është universiteti i dytë publik në Kosovë dhe sot ka rreth 15,000 studentë. Universiteti i Prizrenit është i vetmi universitet në Kosovë që ofron studime Bachelor dhe Master në tri gjuhë, gjegjësisht në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke. Megjithatë, ka vështirësi në akreditimin e programeve në gjuhën boshnjake dhe turke pasi që Agjencia e Akreditimit e Kosovës kërkon së paku 4 profesorë në një drejtim për akreditimin e tij. Disa nga drejtimet në këto gjuhë nuk kanë mjaft profesorë për t’u akredituar. Si rezultat, shumë nga studentët minoritar regjistrohen në programet në gjuhën shqipe. Deri më tani, 573 studentë kanë diplomuar në Universitetin e Prizrenit nga programet në gjuhët tjera, 349 nga programi në gjuhën boshnjake dhe 224 nga programi në gjuhën turke.

Megjithatë, këto programe kanë nevojë për më shumë mbështetje logjistike dhe teknike; programet e tyre të studimit duhet të rridefinohen dhe harmonizohen me trendet bashkëkohore në arsimin evropian dhe në përputhje me komunitetin dhe nevojat e tregut.

Folësja e radhës, Lowri Wynne Williams, Zyrtare e Lartë për Politika në Uells, prezantoi temën “Arsimi i mesëm në Uells – të valëvitësh apo të ngecësh?”. Ajo filloi me një historik për arsimin e mesëm në Uells. Qeveria e Uellsit i ka përcaktuar vetes një cak për një milionë folës të gjuhës uellsiane deri në vitin 2050, si dhe rritjen e përqindjes së personave që flasin gjuhën uellsiane në baza ditore nga 10% deri në 20%. Në vitin 1911 kanë qenë afërsisht një milionë folës të gjuhës uellsiane mbi moshën tre vjeçare në Uells. Deri në vitin 1981, numri u zvogëluar në 504,000. Disa faktorë themelorë për rënie ishin imigrimi, emigrimi, rritja e dominimit të gjuhës angleze dhe negativiteti rezultues drejt një gjuhe minoritare.

Gjatë viteve të 60-ta ka pasur vetëdijesim për rënien e statusit të gjuhës uellsiane dhe folësit e gjuhës uellsiane protestuan duke kërkuar më shumë status dhe masat për ndalimin dhe rikuperimin e kësaj rënie. Për këtë arsye, në vitin 1967 u miratua *Akti për Gjuhën Uellsiane*⁴ dhe iu dhanë të drejta më shumë njerëzve për përdorimin e gjuhës uellsiane në çështje ligjore dhe dokumente zyrtare. Sot, gjuha uellsiane është një gjuhë zyrtare, si rezultat i Masës për gjuhën uellsiane (uellsishten) në vitin 2011. Kjo

³ Kushtetuta e Kosovës, 2008. Në dispozicion në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf> [Qasur më 21 maj 2018]

⁴ Akti për Gjuhën Uellsiane i vitit 1967. Në dispozicion në: <http://www.legislation.gov.uk/ukpga/1967/66/enacted> [Qasur më 20 maj 2018]

masë gjithashtu mundësoi themelimin e Komisionerit për gjuhën uellsiane dhe i obligoi institucionet publike që të përmbushin standardet për t'i dhënë më shumë të drejta folësve të gjuhës uellsiane.

Qeveria e Uellsit, së bashku me autoritete lokale, është përgjegjëse për drejtimin dhe fokusin e sistemit të arsimit në Uells. Shkollat kanë kategori të ndryshme gjuhësore. Të gjitha lëndët jepen në gjuhën angleze dhe uellsiane, dhe gjuhët tjera ndryshojnë sipas kategorisë. Ekzistojnë katër kategori të shkollave: shkollat në gjuhën uellsiane, shkollat dygjuhësore, shkollat në gjuhën angleze dhe shkollat e tjera. Ka pasur një rënie në numrin e shkollave në Uells gjatë dhjetë viteve të kaluara, që nënkupton më pak shkolla në gjuhën uellsiane. Megjithatë, përqindja e shkollave në gjuhën uellsiane nga totali ka mbetur i pandryshueshëm. Kjo nuk përmbushë caqet e përcaktuara nga Qeveria e Uellsit.

Ka pasur përmirësim në arsimin e lartë për shkak të investimeve dhe planifikimit të konsiderueshëm në emër të një organi të dedikuar për zhvillimin e gjuhës në arsimin e lartë. Arsimi ka qenë kyç në ndalimin e rënies së gjuhës uellsiane gjatë dyzetë viteve të kaluara. “Megjithatë, kemi arritur në një pikë ku më nuk ka rritje” tha znj. Williams.

Zhvillimi i gjuhës uellsiane në arsim është një pjesë e rëndësishme e Strategjisë së Qeverisë për vitin 2050. Ajo përfshinë caqet dhe rezultatet, siç është rritja e përqindjes së nxënësve që përfundojnë shkollën dhe janë në gjendje të flasin gjuhën uellsiane, rritja e përqindjes së nxënësve që janë në gjendje të mësojnë gjuhën si lëndë dhe nëpërmjet përdorimit të gjuhës. Caqet dhe treguesit e performancës janë marrë nga gjuha uellsiane në Planin e veprimit për arsim 2017-2021, e cila shkon së bashku me Strategjinë e vitit 2050. Kjo është një kohë shumë kritike për arsimin në gjuhë uellsiane. Është kohë e mundësisë së madhe, por nëse nuk bëhet në mënyrë të duhur, është kohë e rrezikut të madh.

Folësja e radhës në sesion, Orla de Burca, Menaxhere për Komunikim nga Irlanda, falënderoi Komisionerin për gjuhët në Kosovë dhe ekipin e tij për mirëpritjen dhe organizimin e konferencës për këtë vit.

Znj. De Burca punon me Komisionerin për gjuhët në Irlandë (AnCoimisinéirTeanga), zyra e të cilit u themelua në vitin 2004 sipas *Aktit për Gjuhët Zyrtare*⁵. Tema e prezantimit të saj ishte “Sfidat për qasjen në arsim në gjuhën irlandeze dhe mundësitë për t'i tejkaluar ato”. Ajo prezantoi dy elementet kryesore të Aktit të Gjuhëve Zyrtare, ku elementi i parë ishin dispozitat e drejtpërdrejta dhe elementi i dytë skemat e gjuhës. Dispozitat e drejtpërdrejta kanë përfshirë të drejtën e anëtarëve të dhomave të parlamentit për përdorimin e cilësdo gjuhë zyrtare, përgjigjen në komunikim me shkrim në të njëjtën gjuhë zyrtare, shenjat dhe rregulloret në dy gjuhët zyrtare, publikime të caktuara, si propozime të politikave publike, raporte vjetore, llogari dhe pasqyra të audituara të strategjisë, si dhe emra zyrtar të vendeve në dy gjuhët zyrtare. Skemat gjuhësore hartohen kur kërkohet nga ministri dhe duhet të përfshijnë ueb-faqe, shërbime në sportel, shërbime në telefon, formularë dhe fletëpalosje, takime publike etj. Secila skemë zgjatë 3 vite; megjithatë, rekomandohet që sistemi i skemës të zëvendësohet me një sistem të standardeve.

⁵ Akti i Gjuhëve Zyrtare 2003. Në dispozicion në: <https://www.chg.gov.ie/app/uploads/2015/07/Guidebook-Oifig-an-Choimisineara-Teanga-Version4.pdf> [Qasur më 20 maj 2018]

Në vitin 2016, prindërit u ankuan tek An Coimisinéir Teanga lidhur me vendimin e Ministrit për Arsim dhe Shkathësi për të mos i dhënë patronazhin për një shkollë fillore multi-denominale në gjuhën irlandeze në një zonë specifike (Drumcondra/ Marino/Dublin 1), përkundër nivelit të lartë të kërkesës për një gjë të tilla në atë zonë (361 nxënës). Dhënia e patronazhit është hapi i parë në themelimin e një shkolle të re. Është vendosur një proces i ri konkurrues nga Departamenti i Arsimit, ku patronazhi i jepet patronit me numrin më të lartë të nxënësve – ngjashëm me një proces të tenderimit.

Hapi i parë i Komisionerit për gjuhët ishte ekzaminimi i legjislacionit relevant – në mënyrë specifike i *Aktit të Arsimit 1998*⁶. Akti përmban një numër të objektivave – 13 gjithsej, dy nga të cilët kanë qenë relevant për rastin:

- (1) Kontributi në realizimin e politikave dhe objektivave kombëtare në lidhje me zgjerimin e dygjuhësisë në shoqërinë irlandeze dhe në veçanti përdorimin më të madh të gjuhës irlandeze në shkollë dhe në komunitet.
- (2) Promovimi i nevojave gjuhësore dhe kulturore të nxënësve duke pasur parasysh zgjidhjet e prindërve të tyre.

Departamenti ka krijuar një organ të ri, të pavarur, të quajtur “New Schools Establishment Group (NSEG)” për të shqyrtuar aplikacionet për patronazh, posa ato të shqyrtohen dhe filtrohen nga departamenti. NSEG u ngarkua me përgjegjësinë për dhënien e rekomandimeve tek ministri për secilin rast. Organit iu dhanë tri kriteret specifike: gjeografik, numerik dhe diversitetit të karakterit kulturor. Departamenti pohoi që fjala “diversitet” i referohej karakterit dhe gjuhës.

Megjithatë, departamenti theksoi që ata tani kishin vendosur që të shtojnë një seksion të zgjidhjes së gjuhës në formularin që duhet të plotësohet nga prindërit si pjesë e aplikimit për patronazh. Karakteri dhe gjuha do të prezantohen në të ardhmen si dy zgjidhje të veçanta. Një sistem i ri online është duke u prezantuar nga departamenti, i cili do të lehtësojë analizën e të dhënave dhe zberthimin e kërkesës në proces.

Gjetjet e organit të ri nuk janë publikuar ende, por do të përfshihen në raportin tonë vjetor, i cili do të lansohet javën e ardhshme. Megjithatë, ato janë në harmoni me pikëpamjen e Coimisinéir Teanga për rëndësinë e arsimit dhe fuqinë relative të Aktit të Arsimit.

Folësi i fundit për këtë sesion, z. Dukagjin Pupovci, ekspert i arsimit në Kosovë, foli për “Sfidat e mësimi të gjuhëve zyrtare në Kosovë”. Z. Pupovci filloi prezantimin e tij me një shembull personal që shpesh do t’i ndihmonte atij të shpjegojë kompleksitetin e mësimi të gjuhëve të komunitetit në këtë vend. Ai ishte pjesë e gjeneratës ku ata mësuuan gjuhën serbe në shkollë dhe në rrugë. Në vitin 1981 ai filloi studimet në Universitetin e Prishtinës, në fushën e matematikës. Në atë kohë, shumica e profesorëve iu rekomandonin leximin e literaturës ruse sepse Bashkimi Sovjetik vazhdimisht publikonte libra dhe literaturë cilësore. Ato ishin lehtësisht të qasshme dhe të lira. “Gjenerata ime dhe unë e njihnim shumë mirë gjuhën serbe, nuk kishim probleme në kuptimin e literaturës në gjuhën ruse” tha z. Pupovci. Kjo iu ka ndihmuar shumë atyre në universitet.

⁶ Akti i Arsimit 1998. Në dispozicion në: <http://www.irishstatutebook.ie/eli/1998/act/51/enacted/en/pdf> [Qasur më 21 maj 2018]

Katër vite më vonë, gjegjësisht në vitin 1985, z. Pupovci filloi të jap mësim në të njëjtin universitet, ku edhe e vazhdoi praktikën e rekomandimit të literaturës ruse tek studentët e tij. Kjo praktikë vazhdoi deri në vitin 1991, ku ata u larguan nga universiteti. Në atë kohë u krijuan dy universitete nga një universitet: Universiteti serb i mbështetur nga shteti dhe Universiteti shqiptar i persekutuar nga shteti. Ishte interesante në atë kohë kur universiteti u nda në dy pjesë, të dy pjesët kishin të njëjtat programe, por Universiteti serb nuk kishte program në gjuhën shqipe dhe Universiteti shqiptar nuk kishte program në gjuhën serbe. Që nga viti 1991, shqiptarët vendosën të mos e mësojnë gjuhën serbo-kroate dhe serbët kishin vendosur më herët që të mos e mësojnë gjuhën shqipe. Ishte pjesë e identitetit kombëtar të secilit grup që të mos mësojë gjuhën e tjetrit – nuk ishte patriotike kjo. Programi rus u mbyll në Universitetin shqiptar pas rreth tri viteve, pasi që askush nuk dëshironte të mësonte gjuhën e vendit që mbështeti okupimin e Millosheviqit.

Periodha pas luftës solli një boshllëk edhe më të madh ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, deri në atë pikë ku ata preferonin të flisnin në gjuhën angleze edhe nëse njëri e dinte gjuhën e tjetrit. Gjatë këtyre 19 viteve të periudhës pas luftës nuk ka pasur përpjekje serioze nga të rinjtë e Kosovës për të mësuar gjuhën e njëri tjetrit. Sot, personat që njohin gjuhën e njëri tjetrit janë 32 vjeç apo më të vjetër. Shoqëria jonë nuk e ka kuptuar që duke mësuar gjuhën e njëri tjetrit ne nuk humbim kulturën tonë.

Sesioni i tretë: Ballafaqimi me të kaluarën, statusi i gjuhëve në shoqëritë e dala nga konflikti dhe ndikimi i tij në procesin e pajtimit

Sesioni i tretë dhe i fundit lidhur me statusin e gjuhës në shoqëritë e dala nga konflikti u kryesua nga znj. Remzije Istrefi, profesoreshë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Folësi i parë, z. Hilmi Jashari, Avokati i Popullit në Kosovë, shprehu mirënjohjen për organizatorët e konferencës, për punën e tyre dhe për organizimin e konferencës. Ai filloi fjalimin e tij me një citat në gjuhën angleze “Nuk ka formulë të përgjithshme (No size fits all)”, që do të thotë se Kosova ka një të kaluar unike në krahasim me vendet e tjera pasi që ka qenë nën një administratë ndërkombëtare për një periudhë 8 vjeçare. Gjuha e përdorur nga kjo administratë ishte gjuha angleze dhe është mahnitëse se sa ndikim ka pasur kjo administratë në institucionet tona, si autoritet ligj-bërës, si udhëheqës i Këshillit gjyqësor dhe roleve të tjera ekzekutive të cilat tani i ka kryeministri “madje edhe mbretëresha e Anglisë do të jetë xhelozë me kompetencat që një administratë e tillë i ka pasur në Kosovë” tha z. Jashari.

Në vitin 2008, Kosova më në fund nxori kushtetutën e saj me standarde ndërkombëtare dhe duke siguruar mbi të gjitha përdorimin e gjuhëve zyrtare – duke e bërë gjuhën serbe si gjuhë zyrtare, i cili është një tregues i mirë i përfshirjes së tyre në institucionet kosovare. Për perspektivën e ardhshme, lidhshipi kosovar duhet të zgjedhë mekanizmat e tij me mençuri, në mënyrë që ata do të mund të ndihmonin në integrimin e komunitetit serb.

Z. Jashari prezantoi një shembull nga përvojat e tij, ku ishte kërkuar nga Avokati i popullit që të ndihmojë në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Storja ka të bëjë me një fshat që ishte ndarë në dy pjesë: pjesa serbe dhe pjesa shqiptare. Secila nga ato kishte nevojë për diçka nga pjesa tjetër; pjesa shqiptare kishte nevojë të

përdorte mullirin që gjendej në pjesën serbe dhe pjesa serbe kishte nevojë për qasje në tubacionin e ujit që gjendej në pjesën shqiptare. Hapi i parë që u ndërmor për zgjidhjen e problemit ishte caktimi i një takimi me të dyja palët. E gjithë ajo që u diskutua në këtë takim ishin tensionet politike dhe akuzimet e ndërsjella në përgjithësi. Në takimin e dytë, ata filluan diskutimin e problemeve aktuale që kishin në qasjen në mulli dhe në tubacion të ujit. Në takimin e tretë, Avokati i popullit nuk pati nevojë të fliste asnjë fjalë, pasi që ata po bisedonin vetë dhe po ofronin zgjidhje praktike për problemin, madje duke harruar që Avokati i popullit gjendej aty. Ky është një shembull që dialogu ndërmjet dy komuniteteve mund të bëhet dhe mund të zgjidh çështje të mëdha e të përbashkëta.

Përfundimi i komuniteteve minoritare në procesin e vendimmarrjes na tregon që ka ende shumë punë për t'u bërë në këtë aspekt. Avokati i popullit mund të ndërtojë gjithëpërfshirjen multi-etnike në shoqëri duke adresuar të gjitha shqetësimet që janë pjesë e vazhdueshme e jetëve tona të përditshme. Zyra e avokatit të popullit të Kosovës nxjerr çdo vit një raport për rastet në të cilat ka punuar dhe ku qëndron secili komunitet. Ky raport çdo vit dërgohet tek Kuvendi i Kosovës dhe kurrë nuk diskutohet apo merret parasysh. Deputetët e kuvendit nuk e kanë kuptuar që ky raport nuk shkon në kuvend për t'u votuar, por është një mënyrë për t'iu treguar se ku qëndrojmë si shoqëri dhe supozohet t'iu ndihmojë atyre në hartimin e politikave dhe në ndryshimin e ligjeve. Autoritetet kosovare duhet së paku të respektojnë kushtetutën, që paraqet mënyrën e jetesës së këtij vendi, nëse jo duke shqyrtuar raportet dhe strategjitë e ofruara nga Avokati i popullit.

Z. Rafael Sainz de Rozas Bedialauneta, Udhëheqësi i Departamentit për të Drejtat Gjuhësore në Baski, ishte folësi i radhës me prezantimin e temës “Vështrimi në të ardhmen: Normalizimi i dygjuhësisë si rrugë drejt pajtimit në Baski”. Z. Sainz de Rozas theksoi se “Në vijmë nga një komunitet që sapo ka dal nga lufta. ETA është shpërbërë dhe nuk do të ketë më luftë – dje ata zyrtarisht e shpallën shpërbërjen. Lufta e pandershme kundër terrorit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut kanë përfunduar më në fund. Një nga arsyet që ky konflikt është nxitur ishte mungesa e të drejtave gjuhësore, gjuha baske flitet vetëm nga 36% e popullsisë.”

Gjatë periudhës së regjimit të Frankos (1937-1975) kur zhvillohej procesi i uniformizmit politik dhe ligjor, diversiteti gjuhësor shihej si rrezik. Konsideroheshit patriot nëse flisnit gjuhën spanjolle dhe jo gjuhë të tjera. Me përfundimin e diktaturës në vitin 1975, të drejtat gjuhësore u njohën për Baskinë, ata tani kishin mundësi të përdornin të dy gjuhët zyrtare, në të folur dhe në të shkruar. U njohën këto të drejta themelore:

- E drejta për të komunikuar në gjuhën spanjolle apo baske me administratën.
- E drejta për t'u arsimuar në të dy gjuhët zyrtare.
- E drejta për të marrë publikime periodike, për të dëgjuar programet në radio apo TV dhe masmedia të tjera në Baski.
- E drejta për të zhvilluar aktivitete profesionale, të punës, politike dhe sindikale në Euskara.
- E drejta për t'u shprehur në Euskara në çfarëdo takimi.

Me hartimin e kushtetutës spanjolle në vitin 1978, gjatë procesit të decentralizimit janë njohur dy komunitete të veçanta autonome: komuniteti Bask dhe komuniteti Navarre. Të drejtat gjuhësore u

njohën dhe u përshkruan në *nenin 3 të Kushtetutës Spanjolle*⁷ dhe *nenin 6 të Statutit të Autonomisë të Vendit të Baskëve*⁸, siç citohet më poshtë:

Neni 3 i Kushtetutës Spanjolle:

- (1) Gjuha kastiliane është gjuha zyrtare spanjolle e shtetit. Të gjithë spanjollët duhet ta njohin dhe ta përdorin atë.
- (2) Gjuhët e tjera të Spanjës gjithashtu do të jenë zyrtare në komunitetet përkatëse autonome, në përputhje me statutet e tyre.
- (3) Pasuria e modaliteteve gjuhësore të Spanjës është një trashëgimi kulturore që do të jetë subjekt i respektit dhe mbrojtjes së veçantë“.

Neni 6 i Statutit të Autonomisë së Baskisë:

- (1) Euskara, gjuha e popullit bask, do të ketë sikurse gjuha spanjolle statusin zyrtar në Baski dhe të gjithë banorët e saj do të kenë të drejtë të njohin dhe të përdorin të dy gjuhët.
- (2) Institucionet e përbashkëta të Komunitetit Autonom, duke marrë parasysh edhe diversitetin socio-linguistik në Baski, do të garantojnë përdorimin e të dy gjuhëve, duke rregulluar statusin e tyre zyrtar dhe ata do të gjykojnë dhe rregullojnë masat dhe burimet e nevojshme për të siguruar njohjen e tyre.
- (3) Askush nuk mund të diskriminohet për arsye të përdorimit të gjuhëve.

Roli i shkollave është shumë i rëndësishëm në mësimin e gjuhëve. Sot, në Baski ekziston liria për të zgjedhur gjuhën sipas 3 modeleve: Modeli A – spanjolle (+ baske dhe angleze), Modeli B – baske dhe spanjolle (+ angleze) dhe Modeli D – bask (+ spanjolle dhe angleze) dhe përqindja e nxënësve nën moshën 17 vjeçare që ndjekin modelin D është më e larta.

Edhe pse Baskia ka dy gjuhë zyrtare, ato nuk janë të normalizuara. Duhet të ndërmerret veprim afirmativ për të arritur barazinë reale në një situatë jo të balancuar, si dhe planifikim të gjuhëve. Normalizimi jo vetëm që nënkupton bashkekzistencën e të dy gjuhëve, por edhe respektin për të drejtat gjuhësore në një shoqëri që po ndryshon me shpejtësi.

Folësi i radhës për këtë sesion, z. Shkumbin Munishi, profesor i asociuar në Universitetin e Prishtinës, diskutoi lidhur me konceptet e planifikimit gjuhësor dhe përfshirjen e tyre në planifikimin e statusit të gjuhëve në Kosovë, duke pasur parasysh ndikimin e politikave gjuhësore të Bashkimit Evropian. Si mjet i komunikimit ndërmjet njerëzve, gjuha është e lidhur ngushtë me aftësinë e tyre për ta përdorur atë. Nëpërmjet gjuhës paraqitet qëndrimi socio-ekonomik dhe kulturor i një kombi specifik. Në anën tjetër, duke e pasur parasysh që një komunitet jeton dhe vepron në një territor të përbashkët, ku një apo më shumë komunitete flasin gjuhë të ndryshme, marrëdhënia që ata krijojnë me gjuhën e njëri tjetrit reflektohet në respektin që ata kanë për kulturën dhe traditat e tjetrit në përgjithësi. Barazia e gjuhëve është formë e rregullimit të marrëdhënieve ndërgjuhësore, e cila është pjesë e planifikimit të gjuhës dhe politikës linguistike të një subjekti social. Planifikimi i gjuhës është aktivitet jo i lehtë që realizohet për të

⁷ Kushtetuta Spanjolle e vitit 1978. Në dispozicion në:

<https://www.boe.es/legislacion/documentos/ConstitucionINGLES.pdf> [Qasur më 21 maj 2018]

⁸ Statuti i Autonomisë së Baskisë. Në dispozicion në:

http://www.basquecountry.eus/contenidos/informacion/estatuto_guernica/en_455/adjuntos/estatu_i.pdf [Qasur më 21 maj 2018]

rregulluar problemet gjuhësore me mbështetjen e elitave politike dhe kulturore. Duke e pasur parasysh faktin që shumë subjekte sociale dhe qeveritare kanë karakter shumëgjuhësh, madje edhe në rastet kur kemi komunitete pakicë, përcaktimi i statutit të gjuhës është çështje sensitive e rëndësishme. Në shoqëritë shumëgjuhëshe, ndikimi i faktorëve tjerë jo-gjuhësor, si faktorëve ekonomik, kulturor dhe politik ndërton marrëdhënie jo të favorshme ndërmjet këtyre komuniteteve.

Statuti i gjuhës nuk është i mjaftueshëm për të drejtat gjuhësore dhe duhet të shtjellohet më tej. Gjatë periudhës së UNMIK-ut në Kosovë, gjuha angleze ka qenë gjuha më e rëndësishme dhe në atë kohë u aprovua Ligji për gjuhët, sipas të cilit gjuha shqipe dhe gjuha serbe ishin dy gjuhët zyrtare në Kosovë. Që nga atëherë nuk ka përfshirje të cilësdo gjuhë në kurrikulën shkollore në gjuhë tjetër. Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për ta bërë të obligueshme për nxënësit shqiptarë që të mësojnë gjuhën serbe dhe nxënësit serb që ndjekin shkollën në Kosovë të mësojnë gjuhën shqipe.

Folësi i fundit për sesion dhe për tërë konferencën ishte z. Nexhmedin Spahiu, profesor i shkencave politike në Kosovë. Z. Spahiu vjen nga Mitrovica, një qytet që është i ndarë në dy pjesë pas luftës. Pjesa veriore banohet nga serbët dhe pjesa jugore nga shqiptarët. Ai shpjegoi se si kjo ndarje gjeografike ka rezultuar me dallime edhe në gjuhën e folur. Megjithatë, Mitrovica nuk ka qenë e njëjtë sikurse sot. Në kohën e ish Jugosllavisë ishte qyteti me diversitet më të lartë në Kosovë, duke pasur dy gjuhë që bashkekzistonin në mënyrë të barabartë në komunitet. Që para shumë kohësh televizioni i Mitrovicës, përveç në gjuhën shqipe, ka pasur programe edhe në gjuhën boshnjake dhe turke. Ky televizion është edhe shembull i televizionit kombëtar të Kosovës. Roli i medias ishte shumë i rëndësishëm në ndërtimin e marrëdhënieve ndërmjet të gjitha komuniteteve që jetojnë në Mitrovicë dhe në Kosovë.

Platforma online për mësimin e gjuhës

Menaxheri i Projektit “Vocup”, z. Veljko Samardzić, prezantoi platformën e re online të mëimit. Kjo platformë është krijuar me ndihmën e IOM-it dhe Ambasadës Britaneze. Është një platformë online për serbët që të mësojnë gjuhën shqipe dhe anasjelltas – funksionon në të dyja mënyrat. Përveçse është në dispozicion në internet, kjo platformë do të fillojë të shfaqet në televizionin kombëtar RTK 2 dhe do të jetë në formë të fletushkës. Kjo do të mundësojë të nxënit nga distanca, ku e tëra që do t’iu nevojitet është interneti, koha dhe dëshira për të mësuar gjuhë tjetër zyrtare të vendit ku jetoni.

Janë 20 ligjërata, përfshirë mësimin dhe ushtrimet për çdo mësim. Kjo platformë gjithashtu ka përfshirë një fjalor të vogël të krijuar nga organizata në bashkëpunim me OSBE-në. Sot, teknologjia na ofron neve metoda të pafundme për të mësuar gjithçka – një nga ato është edhe kjo platformë. Ky aplikacion nuk ka kufizime, çdokush mund t’i qaset atij me lehtësi nëpërmjet internetit. “Mësimi i një gjuhe të re duhet të jetë pjesë e jetëve tona të përditshme” tha z. Samardzić në fund.

Sesioni përmbledhës

Znj. Remzije Istrefi bëri një përmbledhje të konferencës duke përmendur çështjet më të rëndësishme të diskutuara gjatë ditës. Ajo falënderoi pjesëmarrësit dhe panelistët për pjesëmarrje në këtë konferencë. Ajo theksoi që mbështetja nga institucionet politike është shumë e rëndësishme në zbatimin e gjuhëve zyrtare. Nga të gjithë folësit, mysafirët nga jashtë, vendit mund të mësojmë metodologjitë dhe mjetet e

tyre për zbatimin e kornizës ligjore që përcakton statutin ligjor të gjuhëve në atë vend. Të gjithë mund të mësojmë nga përvojat e njëri tjetrit; prandaj, u jemi falënderues institucioneve tona për mbështetjen e vazhdueshme.

Ka qenë jashtëzakonisht e rëndësishme të dëgjojmë prezantimet nga përfaqësuesit e Kanadasë për Ofertën e tyre Aktive në sesionin e parë lidhur me përmirësimin e ofrimit të shërbimit. Ky koncept ka qenë diçka e re për ne. Besojmë që një mjet i ngjashëm do të merret parasysh dhe përdoret nga autoritetet kosovare duke e përshtatur dhe modifikuar sipas rrethanave të vendit tonë. Një mjet i ngjashëm do të krijonte bazën për qytetarët e Kosovës që të ndjehen më mirë kur marrin shërbimet publike.

Pastaj, përfaqësuesja e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës diskutoi lidhur me kornizën ligjore që është aprovuar në komuna, në Kosovë, për përdorimin e gjuhëve zyrtare. Është shënuar progres në nivel komunal; megjithatë, ka përpjekje për cilësinë e përkthimit të termeve dhe dokumenteve ligjore. Për këtë arsye, rekomandohet krijimi i Asociacionit të Përkthimit në nivel qendror me përkthyes profesional që kanë njohuri për termet profesionale.

Pas kësaj, dy përfaqësuesit e misionit të OSBE-së dhe ambasadës së Zvicrës të cilët me fjalimet e tyre na përkujtuan se këto institucione kanë ndihmuar vazhdimisht institucionet e Kosovës në zbatimin e ligjit dhe rregulloreve të gjuhës. Megjithatë, ata të dy na përkujtuan që ka mospërputhje në zbatimin e këtyre rregulloreve dhe se ne duhet të punojmë në rregullimin e tyre.

Në sesionin e dytë lidhur me të mësuarit e gjuhëve zyrtare nëpërmjet arsimit, një profesor i Universitetit të Prizrenit prezantoi rastin studimor të këtij universiteti si institucioni i parë në Kosovë që ofron diploma Bachelor dhe Master në gjuhën boshnjake dhe turke. Edhe pse është këto komunitete tjera përfitojnë nga të pasurit programet universitare në gjuhën e tyre, ky universitet përballlet me shumë vështirësi, si mungesa e stafit akademik për të vazhduar të jetë i akredituar.

U bënë edhe dy prezantime të tjera lidhur me sfidat e të mësuarit të gjuhëve zyrtare në Uells dhe në Irlandë. Përfaqësuesja nga Uellsi prezantoi sistemin e arsimit në gjuhën uellsiane dhe nëse politikat e të mësuarit të një gjuhe nuk ndryshojnë me kalimin kohës, situata mbetet e njëjtë. Korniza ligjore nuk është e mjaftueshme për të rregulluar, në këtë rast arsimin në Uells, por nevojitet mbështetje e vazhdueshme dhe strategji të reja nga qeveria. Përfaqësuesja nga Irlanda foli për sfidat e qasjes në gjuhën irlandeze. Rekomandimet dhe idetë e saj mund të përdoren edhe në Kosovë.

Folësi i fundit në panel ishte një ekspert i arsimit nga Universiteti i Prishtinës, i cili bisedoi lidhur me karakterin historik të të mësuarit të gjuhëve zyrtare në Kosovë duke qenë vetë pjesë e tij. Dallimet që u krijuan ndërmjet folësve të gjuhës shqipe dhe serbe në vitet e 90-ta janë akoma të pranishme edhe sot.

Sesioni i tretë kishte të bënte me të drejtat gjuhësore në shoqëritë e dala nga lufta. Folësi i parë i këtij paneli ishte Avokati i popullit i Kosovës, i cili foli lidhur me sfidat në zbatimin e të drejtave gjuhësore dhe të komunitetit në Kosovë dhe hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren për tejkalimin e këtyre sfidave.

Përfaqësuesi nga Baskia prezantoi të drejtat gjuhësore të Baskisë dhe konfliktet e tij të vazhdueshme. Fatmirësisht, ky konflikt tani ka përfunduar dhe tani perioda post-konfliktuale dhe ndërtimi i paqes po e presin Baskinë.

Folësi i fundit i konferencës foli për pozitën teorike të statutit të gjuhëve në Kosovë, si dhe rolin e medias në krijimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve që flasin gjuhë të ndryshme.

Fjalimet përmbyllëse

Z. Ronan O'Domhnaill, Komisioneri për Gjuhët në Irlandë, dhe kryesuesi i ri i Asociacionit Ndërkombëtar të Komisionerëve për Gjuhët mbajti fjalimin përmbyllës për konferencën. Ai falënderoi z. Slaviša Mladenović dhe ekipin e tij për organizimin e shkëlqyeshëm të Konferencës për vitin 2018 në Prishtinë.

Ai vazhdoi të flasë për IALC-në si një organizatë e vlefshme. Diversifikimi i saj mbetet një sfidë në të ardhmen; kjo organizatë duhet të hapet për anëtarë të tjerë duke shpjeguar punën që ata bëjnë. IALC gjithashtu do të zhvillojë një dokument të politikave për punën që çdo anëtar bën në asociacion dhe në këtë mënyrë mund të mësojmë nga praktikat më të mira të njëri tjetrit. “Mbështetemi tek njëri tjetri për të mbijetuar, mbështetemi tek njëri tjetri për ndihmë” tha z. O'Domhnaill.

Në fund, ai shfrytëzoi mundësinë për të vlerësuar punën e znj. Meri Huws si kryesuese e asociacionit gjatë dy viteve të fundit dhe përmbylli konferencën e pestë vjetore të Asociacionit Ndërkombëtar të Komisionerëve për Gjuhë.